

URDHËR

Nr. 74, Datë 31/07/2015

Mbi

masat që duhen marrë për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016, në fakultetet e Universitetit të Arteve

Në bazë të nenit 33 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 638, datë 22.7.2015, "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2015 - 2016", Udhëzimit nr.24, datë 31/07/2015, të MAS, "Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015 - 2016", si dhe të nenit 39, pika 1, shkronja ç, pika 2, shkronja g, të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Pranimet në të gjitha programet e **ciklit të parë** të studimeve me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2015 - 2016, të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe rezultateve të fituara në konkursin e pranimit, të organizuar nga FAB, FAS dhe FM, të UART;
2. **Kandidatët**, të cilët konkurrojnë për një program studimi në vitin akademik 2015 - 2016, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë në **FAKULTETET** e Universitetit të Arteve, **kriteri i veçantë** është: vlerësimi për shkollën e mesme të llogaritet në **masën 30 %**, (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe të gjithë provimet e Maturës Shtetërore) dhe **rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70 %**;
3. **Pikët maksimale** që mund të fitojë një kandidat në konkurrim në një program studimi në vitin akademik 2015 - 2016, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë në fakultetet e UART, janë: nga **240, sipas programit**, mbështetur në Udhëzimin nr.24, datë 31/07/2015, të MAS;
4. Kandidati, që nuk arrin të fitojë **pikët minimale**, prej **60**, të përcaktuar në Udhëzimin nr. 24, datë 31/07/2015, të MAS, në programin e studimit për të cilin konkurren, **nuk fiton** të drejtën e studimit;
5. **Konkurset** e pranimit për në fakultetet e Universitetit të Arteve, **zhvillohen**: nga data 26/08/2015 **deri** në datën 29/08/2015, në ambientet e fakulteteve; orari i zhvillimit të konkurseve në fakultete për çdo program studimi të përcaktohet me urdhër të veçantë të dekanëve të fakulteteve;

6. **Tarifa e regjistrimit** të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimit, në të gjitha programet e studimit në fakultetet e Universitetit të Arteve është: **5000 (pesë mijë) lekë**. Tarifa e regjistrimit për konkurrim, në programet e studimit të ciklit të parë në fakultetet e UART, të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrave të Postës shqiptare, për llogari të Universitetit të Arteve.
Konkurentet, pajisen me mandat arkëtimi, nga Drjtoria Ekonomike, pranë Rektoratit të UART, në bazë të cilit bëjnë edhe pagesën në sistemin bankar ose zyrat e postës Shqiptare.
7. FAB, FAS dhe FM të UART, të bëjnë publike, në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Arteve, rubrika "**Trasparenca**": rregulloret dhe programet e konkurseve, **duke filluar nga datë 31/07/2015**;
Publikimi i rregulloreve dhe programet të konkurseve të bëhet edhe në ambjentet e çdo Fakulteti;
8. **Regjistrimi** i kandidatëve për konkurset e pranimit të bëhen, pranë Sekretarive të Fakulteteve, nga datë 12/08/ **deri** në orën **12⁰⁰** të datës 18/08/2015.
Sekretaritë mësimore të FAB, FAS dhe FM, të kryejnë veprimet e regjistrimit të kandidatëve për konkurrim nga: ora **08³⁰** deri në orën **18⁰⁰**; Dekanët e fakulteteve të marrin masat e duhura për këtë qëllim;
Sekretaritë mësimore të fakulteteve, në datën 18 gusht 2015, ora **16⁰⁰** të shpallin listat e konkurrentëve në konkurset e pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë;
9. Regjistrimi i kandidatëve nga sekretaritë e fakulteteve, bëhen **duke u bazuar në listën e sjellë nga AKP**, pranë MAS, për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar formularin A₂;
10. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e MAS, të akorduar për shqiptarët jashtë kufijve të RSH, për për romët dhe ballkano-egjiptianët, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për jetimët, të verbrit, shtetasit e huaj si dhe kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo transferim studimesh, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit, për programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Arteve, **aplikojnë drejtpërdrejt** pranë Sekretarive të FAB, FAS dhe FM;
11. Regjistrimi i kandidatëve për konkurset në fakultetet e UART bëhet sipas këtyre dokumentave:
a) për **shtetasit e RSH**:
1. **Letërnjoftimit ID**;
2. **transferte bankare**, pagesa e tarifës së regjistrimit, në llog. bankare të UART;
b) për **shqiptarët jashtë kufijve të RSH**:
1) pasaportë për jashtë shtetit,;
2) fotokopje e diplomës dhe listës së notave të shkollës së mesme **të noterizuar**;
3) **transferte bankare**, pagesa e tarifës së regjistrimit, në llog. bankare të UART;
12. Sekretaritë e FAB, FAS dhe FM, në momentin e regjistrimit të kandidatit për konkurrim në një nga programet e studimit, e pajisë konkurentin me "**Fletën e Regjistrimit**".
Fleta e Regjistrimit ka këtë përmbajtje:
a. Emri dhe mbiemri i kandidatit;
b. Programin e studimit në të cilin konkuron;

- c. Orën, datën, muaji, viti mësimor, ambjentin, **për t'u paraqitur në konkurim;**
- d. Në fletën e regjistrimit të shënohet edhe: data, muaji, viti mësimor dhe ora e regjistrimit;
- e. Fleta e Regjistrimit, përgatitet në 2(dy) kopje, dhe firmoset nga K/sekretara e fakultetit dhe kandidati për konkurs;
13. Sekretaritetë e fakulteteve, në momentin kur paraqitet një konkurent për t'u regjistruar në një nga programet e studimit, të verifikojnë faktin, a është kërkuesi për t'u regjistruar në listen e sjellë nga AKP ose nga MAS.
Në rast se konkurenti është në listat përkatëse, atëherë të vazdojë procedura e regjistrimit;
14. **Të nesërmen** e përfundimit të procedurave të regjistrimit, brenda **orës 12⁰⁰** Sekretaritetë e fakulteteve, në UART, pasi bëjnë verifikimin sipas listave të sjella nga AKP dhe MAS:
- a. **shpallim listat e konkureteve të regjistruar**, të cilat **publikohen** në faqen zyrtare të internetit të UART, dhe **në ambjete** në hyrje të fakulteteve;
15. Gjithë procedura, e përgatitjes dhe e fazës së konkurrimeve, për pranimet e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë në UART, **monitorohen** nga përfaqësues të autorizuar të MAS dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve;
16. Dekanët e FAB, FAS dhe FM, janë përgjegjës për zbatimin e "Rregulloreve të konkursit të pranimit në UART", të miratuar në SA;
17. Sekretaritetë e FAB, FAS dhe FM, rezultatet e konkurseve të pranimit, t'i hedhin në portalin e Maturës Shtetërore Online, në zbatim të Udhëzimit teknik të dërguara nga AKP.
Listat, për rezultatet e konkurseve të pranimit, hidhen në portalin e Maturës Shtetërore online nga sekretaritetë e fakulteteve sipas procedurave të udhëzimit teknik të dërguar nga AKP. Më pas ato dërgohen në MAS e në AKP, në formë shkresore dhe elektronike (në CD), brenda datë **29 gusht 2015;**
18. Listat emrore të kandidatëve, **me pikët e fituara** në konkursin e pranimit, me firmën e Dekanit të fakultetit, shpallen në faqen zyrtare të internetit të UART dhe në ambjete hyrse të fakulteteve;
19. Sektori i Shërbimit pranë Rektoratit të UART, në bashkëpunim me shoqërinë SH.R.S.F. "NAZERI 2000" shpk, me objekt shërbimi i ruajtjes me roje civile, të UART për vitin 2015, gjatë periudhës së regjistrimit dhe zhvillimit të konkurseve të pranimit, për studentët në fakultetet e UART, të marrë këto masa:
- a. shërbimi i ruajtjes me roje civile të angazhohet maksimalisht, për zbatimin e rregullave në mjediset e UART dhe **të jetë në gatishmëri** në raste konflikti;
- b. të **ushtrohen kontrole** për personat që futen në ambjete të fakulteteve dhe të Rektoratit;



- c. gjatë periudhës, datë 31/07/2015 **deri** datë 29/08/2015, zona e parkimit, brenda teritorit të UART, të jetë e lirë. Në këtë ambient, mund të parkohen vetëm automjetet sipas një liste të miratuara nga Kancelari i UART;
- d. Hyrja e personeli, akademik dhe administrativ, për periudhën e regjistrimit dhe konkurseve të pranimit, do të bëhet **nga hyrja**, në rrugën " Lekë Dukagjini";

20. **Hyrja e konkurrentëve**, do të bëhet vetëm nga hyrja kryesore e Universitetit të Arteve (sheshi Nënë Tereza).

Nga hyrja kryesore konkurrentët **do të shoqerohen nga punonjës të caktuar nga Dekanët e fakulteteve**, për t'u drejtuar në Sekretariatë e fakulteteve ose në ambjentet e fakulteteve ku edhe do të zhvillohen regjistrimet ose konkurset.

21. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen: Zv.rektori për anën mësimore, Dekanët e FAB, FAS, FM, Kancelari i UART, Sekretariatë e fakulteteve, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Shërbimeve, Personeli akademik dhe administrativ me detyra specifike në regjistrimin dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit të studentëve të ciklit të parë në UART, për vitin akademik 2015 – 2016;

22. Ngarkohet DMBNJ, që këtë Urdhër t'a publikojë në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Arteve, rubrika **"Trasparenca", si dhe në ambjentet e fakulteteve.**

23. Ky urdhër, zyrtarisht t'ju dërgohet: MAS, AKP pranë MAS dhe shoqërisë SH.R.S.F. "NAZERI 2000" shpk;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ
REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE